



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 60 Prot.,

Tiranë, më 15.01.2019

V E N D I M

Nr.2, datë 15.01.2019

Për paralajmërimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Departamentit të Administratës Publike, për zbatimin e vendimit nr. 3694 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 4045 dt. 13.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për kthimin e nëpunësit civil *** , në pozicionin e mëparshëm të punës.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit të procesit të zbatimit të vendimit gjyqësor, me objekt rikthimin në punë të nëpunësit civil ***** , liruar padrejtësisht nga detyra,

VËREJ SE :

Me anën e kërkesës së regjistruar me nr. 1536 prot., datë 27.07.2017 dhe dokumentacionit shoqërues, nëpunësi civil ***** , ka vënë në dijeni Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, se është liruar padrejtësisht, nga pozicioni që mbante në shërbimin civil, “Specialist në Sektorin e Administrimit të Tokës” në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Ujrave dhe Tokës, të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në shkelje të procedurës së parashikuar nga ligji dhe në zbatim të gabuar të ligjit material. Në përfundim të verifikimit të ligjshmërisë së këtij veprimi administrativ, Komisioneri me vendimin e tij nr.186 dt. 31.08.2017, pasi ka konstatuar shkelje të procedurës së dhënies së masës disiplinore dhe zbatim të gabuar të ligjit material në drejtim të cilësimit të natyrës së shkeljes disiplinore, ka kërkuar prej Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të konstatojë pavlefshmërinë absolute dhe të anulojë, aktin administrativ nr. 5470 dt. 14.07.2017 “Mbi fillimin e procedimit disiplinor” dhe Vendimin nr. 27 dt. 25.07.2017 “Për marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” të punonjësit *****”

Në të njëjtën kohë, ankuesi ***** i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 27 dt. 25.07.2017 të Komisionit të Disiplinës, me të cilin është vendosur largimi nga shërbimi civil, kthimi i tij në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimi i pagës për gjithë periudhën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në momentin e rikthimit në vendin e mëparshëm të punës.

Vendimi i mësipërm, mbi bazën e ankimit të punëdhënësit, është shqyrtuar edhe në Gjykatën Administrative të Apelit e cila, me vendimin e saj nr. 4045 dt. 13.11.2018 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë nr. 3694, dt. 29.09.2017, duke e kthyer në këtë mënyrë këtë të fundit, në titull ekzekutiv, detyrimisht të zbatueshëm.

Në rrethanat e mësipërme, bazuar në nenin 66/1, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nëpunësi ***** i është drejtuar njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike dhe institucionit të detyruar nëpërmjet vendimit të gjykatës, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke kërkuar sistemimin e tij të menjëhershëm në punën e mëparshme, ose në një pozicion të ngjashëm, për të cilin ai plotëson kërkesat e përgjithëshme e të veçanta.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 8823/1 dt. 27.12.2018, i është drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke i vënë në dukje se është institucioni që ka detyrimin ligjor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë me nr. 4045 dt.13.11.2018 dhe se mbi këtë bazë ka detyrimin që të gjejë një zgjidhje sa më të prshtatshme me qëllim vënien në vend të të drejtës së fituar gjyqësisht.

Nënderkohë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për vitin 2017”, me aktin nr. 658, dt. 01.08.2018, ka filluar monitorimin e gjendjes së zbatimit të vendimeve gjyqësore, duke kërkuar ndër të tjera edhe nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, informacion mbi gjendjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, numrin e nëpunësve gjyqfitues të rikthyer në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, gjendjen e listës së pritjes, fakte në lidhje me ndryshimet e mundshme në pozicionet e punës, pas dhënies së vendimit gjyqësor të formës së prerë, etj.

Në këtë kuadër, është konstatuar edhe mosveprimi në mënyrën e duhur, në rastin e zbatimit të vendimit gjyqësor nr. 3694, dt. 29.09.2017, sipas të cilit nëpunësi ***** duhej të sistemohej menjëherë, në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, ku ai përmbushte kërkesat e përgjithëshme e të veçanta.

Duke qenë se pozicioni i tij, i mëparshëm i punës si “Specialist në Sektorin e Administrimit të Tokës”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, ishte zënë përfundimisht, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, lind detyrimi që pas rregjistrimit në listën përkatëse të pritjes, të bëheshin gjithë përpjekjet për sistemimin e tij në një pozicion tjetër të rregullt në shërbimin civil, brenda institucionit dhe vetëm nëse kjo ishte objektivisht e pamundur duhej të fillonte bashkëpunimi me Departamentin e Administratës Publike për sistemimin e tij në një pozicion tjetër në një institucion tjetër, etj.

Por nga verifikimi i gjendjes së plotësimin të strukturës aktuale, kryer nga grupi i punës së KMSHC, ngritur me autorizimin nr. 884/1 dt. 12.12.2018, u konstatua se pozicioni i punës “Specialist në Sektorin e Programeve të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural”,

në Drejtorinë e Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, në kuptim të ligjit, ishte pozicion i lirë, pavarësisht se në këtë pozicion vazhdonte të punonte ish nëpunësi civil ******, i cili kishte mbushur moshën për daljen në pension të plotë pleqërie.

Në bazë të nenit 65, pika 1/c, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, një nga mënyrat e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, është plotësimi i moshës për pensionin e plotë të pleqërisë. Në kuptim të kësaj dispozite të ligjit, me plotësimin e moshës së pensionit të pleqërisë, marrëdhënia me shërbimin civil, ndërpritet për shkak të ligjit dhe, punonjësi në fjalë, megjithëse vazhdon të kryejë të njëjtën detyrë si më parë, nuk është më pjesë e shërbimit civil.

Marrëdhënia e punës që vazhdon në këtë rast, me miratimin e Sekretares së Përgjithëshme të institucionit, nuk është marrëdhënie pune në shërbimin civil, por një marrëdhënie kontraktore e punës, e cila në kuptim të legjislacionit të shërbimit civil është e kundraligjshme dhe në kuptim të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, është absolutisht e pavlefshme (*pasi memo e dt. 03.09.2018 për zgjatjen e qëndrimit në punë të punonjësit ******, barazohet me një akt emërimi në detyrë*).

Në këto rrethana, marrëdhënia e punës për punonjësin ****** duhet të ndërpritet menjëherë dhe pozicioni i punës “*Specialist në Sektorin e Programeve të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural*” në Drejtorinë e Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, të evidentohet si pozicion i lirë.

Pas kësaj, në kuadër të zbatimit të vendimit nr.186 dt. 31.08.2017 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe vendimit të formës së prerë, nr. 3694, dt. 29.09.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 4045, dt.13.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, ky pozicion duhet ti ofrohet menjëherë, nëpunësit civil ******.

Për këto arsye:

Në bazë të neneve 11, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, neneve 14/d dhe 35, të Rregullores “Për procedurat e mbikëqyrjes dhe inspektimit”,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit për mbajtjen në marrëdhënie pune në pozicionin e shërbimit civil, “*Specialist në Sektorin e Programeve të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural*”, në Drejtorinë e Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, të punonjësit ****** dhe ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës dhe asaj financiare.
2. Institucioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, pas përfundimit të procedurës së mësipërme, të dërgojë menjëherë në Departamentin e Administratës

Publike, propozimin për plotësimin e pozicionit në fjalë, nga nëpunësi civil, *****, sipas urdhërimit të vendimit gjyqësor.

3. Njësia Përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në bazë të nenit 66/1, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe në zbatim të vendimit nr. 3694 dt. 29.09.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 4045 dt. 13.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, të emërojë në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Programeve të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural*”, në Drejtorinë e Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, nëpunësin civil *****.
4. Veprimet e mësipërme të kryhen brenda një afati 5 ditor, nga marrja njoftim për këtë vendim.
5. Ky vendim ti njoftohet, Departamentit të Administratës Publike, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe nëpunësit *****.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi, brenda afatit të caktuar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, do të veprojë, ndaj personit përgjegjës, sipas pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha